

# LËSHIMI I EKSTRAKTEVE ELEKTRONIKISHT TË NËNSHKRUARA

**Shtator 2015**


## Lëshimi i ekstrakteve elektronikisht të nënshkruara

Portali e-Albania ([www.e-albania.al](http://www.e-albania.al)), krahas shërbimeve të tjera, ofron edhe shërbimin e lëshimit të ekstrakteve elektronikisht të nënshkruara (të thjeshta dhe historike). Nga ky shërbim mund të përfitojnë si individët, ashtu edhe bizneset (subjektet e regjistruara). Për të marrë ekstraktin/et e kërkuar, duhet të ndiqni hapat si më poshtë:

### Lëshimi i ekstrakteve me kërkesë të një individi (qytetar)


Një individ/qytetar mund të bëjë kërkesë për të marrë ekstrakte të një subjekti tregtar, - shërbimi “Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (qytetar)”, nëse ai është regjistruar më parë me të dhënat e tij te portali e-Albania. Nëse individi nuk është regjistruar, atëherë duhet të krijojë profilin e tij.

Fillimisht hyni në portalin [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al), klikoni butonin "Hyr" siç tregohet në figurën nr.1, Më pas duhet të vendosni të dhënat e sakta: Username (numri personal i kartës së identitetit) dhe Password (fjalekalimi), të cilin e keni vendosur gjatë fazës së regjistrimit. Për të vazhduar më tej shtypni butonin "Identifikohu".



**Figura 1. Logimi.**

Më pas individi/qytetari, duhet të përzgjedhë: “**Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (Qytetar)**”, siç tregohet në figurën më poshtë, për të shkarkuar ekstraktet e kërkuara.



**Figura 2. Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar(qytetar).**

Hapat që duhet të ndiqni për të tërhequr ekstraktin historik, janë:

- Logohuni në portalin qervertar *e-albania.al*.
- Individit që kryhen aplikimin duhet të jetë i pajisur me kartë identiteti apo pasaportë biometrike për të vërtetuar të dhënat e tij personale.
- Ndjekja me kujdes e të gjitha hallkave të procedurës për shkarkimin e ekstraktit historik.

\* *Ky shërbim ofrohet pa pagesë.*

Pasi të keni përzgjedhur shërbimin” “**Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (Qytetar)**”, klikoni butonin “**Përdor**”.



**Figura 3. Përdor shërbimin “Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (Qytetar)”**

Pasi keni klikuar butonin “Përdor”, në të djathtë të ekranit tuaj do të shfaqet figura më poshtë. Për me tej, aplikuesi (individ) duhet të vendosë NUIS (NIPT), te fusha e shënuar me ngjyrë të kuqe (shih Fig. 4) dhe përzgjedhë llojin e ekstraktit që dëshiron (i thjeshtë ose historik).



The screenshot shows a web form titled "Ekstrakt të biznesit nga QKR". At the top center is the QKR logo, which consists of the letters "OKR" in a stylized font, with "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" and "National Registration Center" written below it. Underneath the logo, the text "Të dhëna nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit" is displayed. Below this, there is a label "NIPT" followed by a red-outlined input field. Underneath the input field, there are two radio buttons: "Ekstrakt i Thjeshtë" (which is selected) and "Ekstrakt Historik". At the bottom of the form is a button labeled "Dërgo kërkesën për ekstrakt".

*Figura 4. Aplikimi për ekstrakt të nënshkruar.*

Pasi keni vendosur (NUIS) NIPT dhe përzgjedhur llojin e ekstraktit, klikoni mbi butonin “**Dërgo kërkesën për ekstrakt**” (shih Fig. 4). Ekstrakti i përzgjedhur do t’ju dërgohet i nënshkruar elektronikisht në e-mailin tuaj.

### **Lëshimi i ekstrakteve me kërkesë të vetë subjektit**

Një subjekt mund të bëjë “*Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar*” nëse ai është regjistruar ndërkohë me të dhënat e tij te portal e-albania. Nëse nuk është regjistruar, atëherë duhet të krijojë profilin e tij.

Për shkarkimin e ekstrakteve elektronikisht të nënshkruara nëpërmjet portalit e-albania, fillimisht logohuni në portalin e-albania (shih Fig. 5).



**Figura 5. Logimi**

Pasi të jeni loguar në portalin e-albania, duhet të përzgjedhë: **“Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (Biznes)”**, siç tregohet në figurën më poshtë, për të shkarkuar ekstraktet e kërkuara.



**Figura 6. Përdor shërbimin “Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar (Biznes)”**

Për me tej, aplikuesi duhet të vendosë NIPT (NIPT), të fusha e shënuar me ngjyrë të kuqe (shih Fig. 7) dhe të përzgjedhë llojin e ekstraktit që dëshiron (i thjeshtë ose historik). Pas kësaj, klikoni butonin “**Dërgo kërkesën për ekstrakt**” dhe ekstrakti i përzgjedhur do t’ju dërgohet i nënshkruar elektronikisht në e-mailin tuaj.



Ekstrakt të biznesit nga QKR

**OKR**  
Qendra Kombëtare e Regjistrimit  
National Registration Center

**Të dhëna nga  
Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit**

NIPT

Ekstrakti i Thjeshtë  Ekstrakt Historik

*Figura 7. Kërkesë për ekstrakt të nënshkruar(biznes).*